



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 878 Prot.

Tiranë, më datë 25.06.2021

VENDIM
Nr. 305, datë 25.06.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.06.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e Rezultatit të Gërmimit Arkeologjik të Shpëtimit në kuadër të projektit “Rruga Lidhëse Bypass Fier - Parku Arkeologjik Apoloni, Sektori A”, me zhvillues ARSSH, paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji “Ad Star” sh.p.k;
2. Të ruhen “in situ” strukturat e zbuluara (ura e periudhës romake, ura e periudhës helenistike dhe godina e banimit të periudhës romake), nga gërmimi arkeologjik i shpëtimit në Sektorin “A”, me qëllim ekspozimin e tyre për vizitorët;
3. Subjekti “AD STAR” sh.p.k. të marrë masa për përgatitjen e kartelave të objekteve arkeologjike më përfaqësuese dhe t’i depozitojë ato pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Pasurisë Kulturore për regjistrim;
4. Subjekti “AD STAR” sh.p.k, të marrë masa për përmbushjen e detyrimit ligjor në lidhje me publikimin e materialit arkeologjik sipas parashikimeve dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren e Kriteve të Ushtrimit të Profesionit të Arkeologut, miratuar me Vendim Nr.2, datë 30.01.2009 të KKA;
5. Punimet e zbatimit për lidhjen e urës me parkingun e Parkut Arkeologjik të Apolonisë të realizohen nën mbikëqyrjen e specialistëve të NJAKPA Apoloni;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

